



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**C-IV.-14-5410**

*Parashtruesi i ankesës:*

**A. T K**, Prishtinë

Kundër:

*Pala kundërshtare:*

**Ndërmarrja Shoqërore ‘P’**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, më 26 maj 2020, lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

**I. Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ036-0577 i datës 18 qershor 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

**II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 16 korrik 2014, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëtejme: AKP) nr. PRZ036-0577 i datës 18 qershor 2014.

Administrata Tatimore e Kosovës kërkon nga Dhoma e Posaçme që të aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe të obligojë AKP-në që të paguajë tatimin në vlerën e shtuar për periudhat 12/2001 deri më 01/2006 në shumë totale prej 210,868.98 euro.

Në mbështetje të ankesës, ankuesi ka dorëzuar provat vijuese:

- *vendimin e kundërshtuar të AL-së, PRZ036-0577 i datës 18 qershor 2014;*
- *formularin e kërkesës për likuidim të datës 13.09.2006;*
- *gjendjen e tatimpaguesit i datës 15.07.2014.*

Me vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së sipas kërkesës me nr. PRZ036-0577 i datës 18 qershor 2014, të parashtruar nga A T K për pagesën e tatimit në vlerën e shtuar për periudhat 12/2001 deri më 01/2006 në shumë totale prej 210,868.98 euro, është aprovuar pjesërisht për shumën prej 95,433.58 euro ndërsa është refuzuar në shumën prej 115,435.40 euro.

Në këtë vendim AKP-ja arsyetoi se sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa mund të përfshijë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të AL-së, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës së kërkesës themelore.

Në bazë të Nenit 37 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjyqtarja e Dhomës së Posaçme nxjerr një urdhër me të cilin ankesa e dorëzuar nga parashtruesi i ankesës i dërgohet AKP-së për përgjigje në ankesë.

Më 9 mars 2020, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë në të cilën ka pohuar se AL-ja ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të saktë.

AKP-ja gjithashtu ka pohuar se neni 37.3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 parasheh që: ‘të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë interes mbi secilën shumë themelore që është grumbulluar para datës së vendimit të likuidimit, me kusht që ky interes të mos tejkalojë 10% të shumës themelore’.

Sipas AKP-së rregulloret tatimore të përmendura nga parashtruesi nuk janë në kundërshtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 sepse rregulloret e cituara nga parashtruesi thjeshtë parashikojnë se interesi duhet të paguhet por nuk specifikon lartësinë e interesit. Andaj propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 06 L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligji për Dhomën e Posaçme).

Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ036-0577 i datës 18 qershor 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Interpretimi i mësipërm është në linjë me jurisprudencën e qëndrueshme të Dhomës së Posaçme. [Shih, për shembull: lëndët C-IV-13-1769, C-IV-13-1922, AC-I-16-0180 etj.].

Sipas nenit 37.3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 parasheh që: ‘të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë interes mbi secilën shumë themelore që është grumbulluar para datës së vendimit të likuidimit, me kusht që ky interes të mos tejkalojë 10% të shumës themelore’.

Gjykata konstaton se kjo dispozitë ligjore mbizotëron mbi dispozitat e legjislacionit fiskal të parashtruara nga ankuesi.

Procesi ligjor i likuidimit të NSH-ve është një procedurë kolektive ku ligjvënësi ka siguruar që ekziston mundësia që kreditorëve të renditur më ulët në renditjen e përparësisë së pagesave, t’iu paguhet diçka.

Neni 37.3 ka rëndësi të madhe lidhur me këtë ngase do të jetë edhe më e mundshme që të ardhurat nga asetet e likuiduara do të shfrytëzohen nga kërkesat me renditje më të lartë sipas nenit 40 të cilat do të bëhen më të mëdha përmes akumulimit të kamatës mbi shumën themelore.

Gjykata vlerëson se neni 37.3 parandalon këtë dhe kufizon shumën e kamatës në 10% të shumës themelore të kërkesës kreditore. Ai vepron me vetëm dy kategori ligjore, e para është shuma themelore e kërkesës kreditore dhe e dyta është kamata për shumën themelore të saj.

Atë të cilën ankuesi po përpiqet ta bëjë se ndëshkimet dhe kamata janë dy kategori të ndara dhe të definuara si të tilla në legjislacionin fiskal, nuk është e vlefshme për këtë procedurë, sepse edhe dënimet llogariten lidhur me shumën themelore për këtë procedurë, sepse edhe dënimet llogariten lidhur me shumën themelore të kërkesës kreditore, pikërisht si kamata fiskale dhe për shkak të kësaj, ato bien në të njëjtën kategori të dytë të parashikuar nga Neni 27.2 të kufizuara në 10% të shumës themelore.

Kërkesa e tanishme e kreditorit është bërë në procedurat e likuidimit të rregulluar me Ligjin nr. 04/L-034 për AKP-në dhe rrjedhimisht ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë të Ligjit të Kosovës që nuk është në përputhje me të (Neni 31.1).

Një zgjidhje tjetër në lidhje me kreditorin fiskal, bazuar në cilësinë e ATK-së si autoritet i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës, do të përbënte diskriminim në mesin e kreditorëve dhe nuk ka ndonjë mbështetje as në Nenin 36, ose në cilëndo dispozitë tjetër të Ligjit për AKP-në.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile ankesa është e pabazuar.

Andaj, në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me Nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Shpenzimet Gjyqësore:**

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Në pajtim me Nenin 8.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të KGJK-së nr. 01/2017 të datës 22 mars 2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**GJYQTARJA,**  
**Manushe Karaçi**